



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:107366
Datë: 30.04.2024
Numri i dokumentit: 05638743
KPPP.nr.448/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Izolimi Com” SH.P.K., me NUI:811273854, me seli në Prishtinë, Përroi i Njëmet magjistratja Prishtinë Mitrovicë, kundër debitorit “Ashala” N.SH., me NUI: 810951097, me seli në Prishtinë, rruga “Ukshin Kovaçica” Bll-C5 ob-D1 K-2 nr.9, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.385/22 të datës 15.04.2022, të Përmbartuesit Privat Flamur S. Bogaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 30.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Ashala” N.SH., ANULOHET Urdhri Përmbartimor P.nr.385/22 i datës 15.04.2022, i Përmbartuesit Privat Flamur S. Bogaj, dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.385/22 të datës 15.04.2022, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës Nr.12-210-001-21 të datës 02.03.2021, me të cilin e ka detyruar debitorin që në emër të përmbartjes së obligimeve nga faturat më sipër, t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 4,300.00 €, me kamatën prej 8%, nga data kur kërkesa është bërë e arritshme e deri me pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, nën kërcënimin e përmbartimit me dhunë, me bartjen e mjeteve financiare nga llogaria bankare e debitorit në llogarinë e veçantë bankare të kreditorit, me regjistrimin, konfiskimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi të debitorit dhe pagesën e borxhit nga shitja e këtyre sendeve.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor duke theksuar se dokumenti përmbarimor nuk përmban titull ekzekutiv, nuk është i nënshkruar nga debitori e as i vërtetuar, andaj urdhri i lejuar nga përmbaruesi privat është i kundërligjshëm. Tutje ka shtuar se kontrata e lidhur mes kreditorit dhe debitorit nuk është përmbushur brenda afatit të përcaktuar me kontratë, andaj kreditori është në vonesë ndaj debitorit lidhur me mos përmbushjen e detyrimit kontraktual e jo debitori ndaj kreditorit. Gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbarimor ta shfuqizoj.

Kreditori në përgjigje në prapësim, ka theksuar se procedura përmbarimore është iniciuar në bazë të Faturën Nr.12-210-001-21 të datës 02.03.2021, e cila faturë i plotëson të gjitha kushtet e dokumentit të besueshëm në bazë të së cilit iniciohet procedura përmbarimore. Tutje ka shtuar se sa i përket provave të bashkangjitura nga debitori të njëjtat nuk qëndrojnë pasi që fatura e cila është objekt i kësaj procedure përmbarimore është lëshuar për punimet e bëra në Klan Kosova e jo për punimet e bëra sipas kontratës të cilën e ka bashkangjitur debitori. Gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbarimor ta vërtetoi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke i'u referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet dhe procedura përmbarimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Fatura Nr.12-210-001-21 e datës 02.03.2021, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 paragrafit 1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”* dhe me paragrafin 3 të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për*

përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti i besueshme - Fatura Nr. 12-210-001-21 e datës 02.03.2021, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbarrim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht nuk përmban nënshkrimin e as vulën e debitorit dhe nuk ka dëshmi se e njëjta është pranuar nga debitori.

Duke qenë se debitori nuk ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën e lartcekur, si e tillë nuk mund të shërbejë si dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbarrueshmërisë, përderisa njëra palë procedurale - debitori nuk ka pranuar një detyrim që rrjedh nga fatura.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të palëve, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarrimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarrimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbarrimi.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumentet e besueshme, mbi të cilat mbështetet propozimi për përmbarrim, e mbi bazën e të cilave përmbarruesi privat ka lejuar përmbarrimin, nuk kanë tipare të përmbarrueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbarruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundojë në tërësi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.448/24, datë 30.04.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerçiale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.